Polytechnic University of Tirana
Institute of Geosciences
Department of Meteorology

2023
VOLUMI / VOLUME NR.7
NUMRI / ISSUE 73
JANAR / JANUARY

BULETINI MUJOR KLIMATIK

CLIMATE MONTHLY BULLETIN

www.geo.edu.al

ISSN: 2521-831X

Scientific & Editorial Board

Ky buletin u realizua me kontributin e punonjësve të Departamentit të Meteorologjisë së IGJEO sipas rubrikave si vijon:
This bulletin has been realized by the staff contribution of the Department of Meteorology of IGEO by rubrics as follows:

Data digitalization: M.Sc. Gentiana STAFA
Data control, verification & and elaboration:
Prof.Dr. Petrit ZORBA, M.Sc. Gazmir ÇELA, Eng. M.Sc. Elsuida HOXHA & Eng. M.Sc. Anira GJONAJ.
Evaluation of monthly meteorological characteristics:
Prof.Dr. Petrit ZORBA, M.Sc. Gazmir ÇELA
Solar radiation: M.Sc. Gazmir ÇELA
Air temperatures: Prof.Dr. Petrit ZORBA &
Prof. Assoc. Enkeleida KUCAJ
Agrometeorology: Prof.Dr. Petrit ZORBA & M.Sc. Gazmir ÇELA
Winter Season: Prof.Dr. Petrit. ZORBA
Wind and Energy: Prof.Dr. Petrit ZORBA
The cover of this bulletin is composed and prepared by
Eng. M.Sc. Elsuida HOXHA

NR.73-2023

PËRMBAJTJA / CONTENTS

04 SHËNIM EDITORIAL
EDITOR'S NOTE

05 HYRJA
INTRODUCTION

06 RREZATIMI DIELLOR
SOLAR RADIATION

09 TEMPERATURAT E AJRIT
AIR TEMPERATURES

16 RESHJET ATMOSFERIKE
ATMOSPHERIC PRECIPITATION

22 AGROMETEOROLOGJI
AGROMETEOOLOGY

24 ARTIKULL SHKENCOR
SCIENTIFIC PAPER

Buletini Mujor Klimatik Nr. 73 - 2023 ndodhet i publikuar në faqen "on line" të OBM, UPT, IGEO dhe një sërë institucioneve të tjera. Për buletinet e tjera mund të klikoni në logot përkatëse, që ndodhen në vijim.

Monthly Climate Bulletin Nr. 73 - 2023 is published on the web site of WMO, PUT, IGEO and other institutions. For the other bulletins you can clik on the respective logo, that are listed below.

Shënim Editorial

Buletini Mujor Klimatik i përgatitur çdo muaj nga Departamenti i Meteorologjisë së Institutit të Gjeoshkencave të Universitetit Politeknik të Tiranës, paraqet një përmbledhje shkencore të vlerësimit të karakteristikave kryesore meteorologjike të muajit përkatës; si dhe në kontekstin klimatik një krahasim me vlerat përkatëse të periudhave të normës klimatike 1961-1990 dhe 1991-2020.

Të dhënat autentike të përftuara nga vendmatjet meteorologjike të Sistemit Kombëtar të Monitorimit Meteorologjik të Shqipërisë pasi janë digjitalizuar, kontrolluar e verifikuar përpunohen në bazë të metodologjive në përputhje me standartet e OBM. Më pas rezultatet e përftuara nga përdorimi i programeve të ndryshme komjuterike paraqiten në tabela, grafikë dhe harta duke mundësuar një vlerësim jo vetëm në kohë por dhe hapësinor të ecurisë së elementëve kryesore meteorologjikë dhe klimatikë. Paraqitja e anomalive përkatëse mundëson dhe një vlerësim të veçantë në konteksin e ndryshimeve klimatike dhe pasojave që ato përcjellin.

Në buletin një hapësirë të veçantë zenë dhe tematika mbi vlerësimin agrometeorolgjik të muajit apo ato mbi burimet e energjive të rinovueshme, siç janë energjia nga rrezatimi diellor apo era, të para më gjërësisht dhe në kontekstik klimatik të vendit tonë.

Buletini është i pajisur me kodin përkatës të ISSN të përftuar nga institucioni përkatës në Paris në vitin 2017. Në të publikohen herë pas here dhe artikuj shkencorë me tematikë në lidhje me klimën dhe mjedisin dhe që i nënshtrohen paraprakisht proçedurave të miratimit ashtu si në periodikët e tjerë shkencorë.

Dukuritë ekstreme të motit apo tematika të caktuara alternohen herë pas here sipas rëndësisë që paraqesin dhe periudhës së vitit. Çdo vit ky buletin ka patur përparësi një tematike të caktuar që për vitin 2023 do të jetë trajtimi i problemeve të thatësirës dhe energjisë nga era.

Editor's Note

The Monthly Climate Bulletin, produced monthly by the Department of Meteorology at the Institute of Geosciences, Polytechnic University of Tirana, provides a scientific summary of the main meteorological features for the given month, along with a comparison to climate norms from 1961-1990 and 1991-2020.

The authentic data obtained from the meteorological measurement sites of the National Meteorological Monitoring System of Albania, after being digitized, checked and verified, are processed based on methodologies in accordance with OBM standards. Then, the results obtained from the use of different computer programs are presented in tables, graphs, and maps, enabling an evaluation not only in time but also in space of the progress of the main meteorological and climatic elements. The presentation of relevant anomalies also enables a special assessment in the context of climate change and the consequences they convey.

In the bulletin, a special space focuses on the agrometeorological assessment of the month or those on renewable energy sources, such as energy from solar radiation or wind, viewed more widely and in the climate context of our country.

The bulletin is equipped with the corresponding ISSN code obtained from the relevant institution in Paris in 2017. Occasionally, scientific articles related to climate and the environment are published in it, subject to prior approval procedures, similar to other scientific journals in the country.

Extreme weather phenomena or certain topics alternate from time to time according to the importance they present and the time of year. Every year, this bulletin has prioritized a certain theme, which for 2023 will be the treatment of drought and wind energy problems.

Prof. Petrit ZORBA
EDITOR-IN-CHIEF

ISSN INTERNATIONAL STANDARD SERIAL NUMBER INTERNATIONAL CENTRE
ISSN PORTAL The Global Index for Continuing Resources

HYRJE

Muaji janar 2023 u karakterizua kryesisht nga një mot i paqëndrueshëm dhe me reshje mbi vlerat e normës në territorin e Shqipërisë.

Gjithësesi temperaturat e ajrit ruajtën në vijimësi ashtu si dhe të muajit të mëparshëm dhjetor 2022 anomali pozitive, të cilat shënuan për muajin janar 2023 vlerën +2.9°C për Shqipërinë.

Nuk munguan orët me diell, të cilat shënuan vlera nga 80 deri në 150 orë në vartësi dhe të kushteve fiziko gjeografike të vendit.

Ajo çka ishte karakteristikë kryesore ishin reshjet e shumta mbi normë që e dallojnë vendin tonë dhe në shkallë kontinentale, të karakterizuar me vlera deri në mbi 300 mm ose mbi 200% kundrejt vlerave të mesatares shumëvjeçare.

Natyrisht në zonat e larta të vendit nuk munguan reshjet e dëborës, por gjithësesi duhet thënë se ato ishin të moderuara kundrejt asaj që është karakteristike për këto zona në këtë periudhë të vitit.

Gjatë muajit janar 2023 në territorin e vendit tonë nuk u vrojtuan dukuri eksetreme të motit me impakte në jetën dhe veprimtarinë e shoqërisë.

Viti i ri 2023 nisi me një situatë temperaturë të pazakontë, ku anomalitë e temperaturës së ajrit për datën 1 janar 2023 në pjesën qendrore të kontinentit Europian shënuan vlera deri në +14°C, siç paraqitet dhe në figurën në vijim.

INTRODUCTION

The month of January 2023 was mainly characterized by unstable weather and rainfall above normal values in the territory of Albania.

However, air temperatures continued to maintain positive anomalies, as in the previous month of December 2022, which marked for January 2023 the value of +2.9°C for Albania.

There was no shortage of sunny hours, which ranged from 80 to 150 hours depending on the physical and geographical conditions of the country.

What was the main characteristic was the numerous precipitations above the norm that distinguish our country on a continental scale, characterized by values up to over 300 mm or over 200% compared to the multi-year average values.

Of course, there was no lack of snowfall in the high areas of the country, but it must be said that they were moderate compared to what is typical for these areas at this time of the year.

During the month of January 2023, in the territory of our country, no extreme weather events with impacts on the life and activity of the society were observed.

The new year 2023 started with an unusual temperature situation, where air temperature anomalies for January 1, 2023 in the central part of the European continent recorded values up to +14°C, as shown in the following figure.



RREZATIMI DIELLOR

Viti i ri 2023 nisi me një ditë me diell siç tregohet dhe në figurë Nr.1, ku më pas gradualisht paqëndrueshmëritë atmosferike mbizotëruan duke mundësuar një rritje të vranësirave dhe një numër ditësh me reshje, të cilat analizohen në mënyrë më të detajuar në vijim. Si rrjedhojë dhe rrezatimi diellor në këtë muaj u shoqërua me luhatje në varësi të mbulesës së vranësirave.



Figure Nr.1. – Pamje e qiellit mbi Tiranë datë 1 janar 2023.
Sky view in Tirana on January 1, 2023.

SOLAR RADIATION

The new year 2023 started with a sunny day as shown in Figure No.1, where then gradually atmospheric instabilities prevailed enabling an increase in cloudiness and a number of rainy days, which are analyzed in more detail in the following. As a result, the solar radiation in this month was accompanied by fluctuations depending on the cloud cover.



Figura Nr. 2 - Pamje satelitore ditore të muajit Janar 2023 mbi territorin e Shqipërisë sipas Eodis Worldview.
Daily satellite view of January 2023 over the territory of Albania according to Eodis Worldview.

Ndërkohë, sa i takon rrezatimit diellor dhe në veçanti treguesit të orëve me diell duhet thënë se gjatë këtij muaji në territorin e vendit tonë u shënuan gjithsejt rreth 80-150 orë me diell, natyrisht me ndryshime në vartësi të zonave dhe nënzonave të ndryshme klimatike.

Një pamje e shpërndarjes së vlerave të këtij treguesi për Shqipërinë paraqitet në hartën e dhënë në figurën Nr.3.

Meanwhile, as regards solar radiation and in particular the indicator of sunny hours, it should be said that during this month in the territory of our country, a total of 80-150 sunny hours were recorded, of course with changes depending on different climatic zones and subzones.

An image of the distribution of the values of this indicator for Albania is presented in the map given in figure No.3.



Figura Nr. 3 – Kohëzgjatja e diellëzimit në (orë) në muajin janar 2023 sipas Eumetsat.

Suneshine duration in (hours) on January 2023 according to Eumetsat.

Një vlerësim për diellzimin për muajin janar 2023 për disa nga vendmatjet meteorologjike të SKMM, paraqiten grafikisht në figurën Nr.5. Sasia e orëve me diell të matura nga stacionet meteorologjike janë në përputhje me matjet satelitore të Eumetsat.

Të dhënat tregojnë për 125 orë me diell në Koplik, 100 orë me diell në Fier, 82 orë në Pogradec dhe 104 orë me diell në Konispol.

Gjithashtu në vijim në figurën Nr.4 paraqitet harta me të dhënat e ndriçimit measatar natyror për muajin janar 2023 për vendin tonë të shprehuar në kLux.

An estimate for the sunshine for the month of January 2023 for some of the meteorological measurement sites of SKMM, is presented graphically in figure No.5.

The amount of sunshine hours measured by the meteorological stations are consistent with the Eumetsat satellite

The data indicates 125 hours of sunshine. in Koplik, 100 hours of sunshine in Fier, 82 hours in Pogradec and 104 hours of sunshine in Konispol.

Also below in figure No.4 is the map with the average natural lighting data for the month of January 2023 for our country expressed in kLux.

Figura Nr.4 – Ndriçimi mesatar ne kLux per muajin janar 2023 sipas Eumetsat.

Monthly mean Daylight in kLux for January 2023 according to Eumetsat.





Figura Nr 5/ a,b,c dhe d – Kohëzgjatja e diellëzimit (në orë) për muajin janar 2023 për disa vendmatje meteorologjike të Shqipërisë.
Sunshine duration (in hour) for January 2023 some meteorological stations of Albania.

TEMPERATURAT E AJRIT

Në shkallë globale muaji janar 2023 u karakterizua me vlera të larta të temperaturave të ajrit krahasuar me vlerat e normës. Sipas raportit global të klimës për muajin janar 2023, temperatura mesatare globale e këtij muaji ishte 12.0°C ose 0.87°C mbi mesataren e shek. të 20-të. Sipas të dhënave shumëvjeçare muaji janar 2023 ishte muaji i shtatë më i ngrohtë në rregjistrin global 174-vjeçar.

Në figurën Nr. 6 dhe Nr. 7 paraqiten harta me situatat e temperaturave dhe anomalive të tyre në shkallë globale si dhe për kontinentin Europian për muajin janar 2023.

AIR TEMPERATURES

On a global scale, the month of January 2023 was characterized by high air temperature values compared to normal values. According to the January 2023 global climate report, thin month average temperature was 12.0°C or 0.87°C above the century average. the 20th. According to multi-year data, January 2023 was the seventh warmest month in the 174-year global record.

In figure No. 6 and No. 7, maps are presented with temperature situations and their anomalies on a global scale as well as for the European continent for the month of January 2023.



Figure Nr.6 - Anomalitë e temperaturës së ajrit pranë sipërfaqes për muajin Janar 2023 kundrejt periudhës 1991÷2020 në shkallë globale dhe për kontinentin Europian.
Surface air temperature anomaly in global scale and for the European continent for January 2023 compared to the period 1991÷2020 (Copernicus, ECMWF, etc.).



Figure Nr.7. - Vlerat e temperaturave mesatare të ajrit dhe anomalive të tyre për kontinentin Europian për muajin Janar 2023, sipas NOAA-s.
Values of mean air temperatures and their anomalies for the European continent for the month of January 2023, according to NOAA.

Situatat e ndryshme sinoptike ilustruar dhe në hartën e dhënë në figurën Nr.8 me një tipike prej tyre, që u alternuan herë pas here gjatë muajit janar 2023 mbi kontinentin Europian përcollën dhe mjaft paqendrueshmëri atmosferike që u reflektuan dhe në ecurinë e temperaturave.

The different synoptic situations illustrated in the map given in Figure No. 8 with a typical one of them, which alternated from time to time during the month of January 2023 over Europe, conveyed a lot of atmospheric instability that was also reflected in the trend of temperatures.

Figure Nr.8. – Situata sinoptike në Europë në orën 00:00 UTC, datë 19 janar 2023 sipas "Wetter3.de".

Synoptic situation in Europe at 00:00 UTC, January 19, 2023 according to "Wetter3.de".



Ecuria e anomalive të temperaturave të ajrit në shkallë kontinenti sipas javëve të ndryshme për muajin janar 2023, paraqiten ne hartat e figurës Nr.9.

The progress of air temperature anomalies on a continental scale according to different weeks for the month of January 2023, are presented in the maps of figure No.9.



Figura Nr.9. -Vlerat e anomalive të temperaturave mesataret e ajrit për kontinentin Europian për 4 javët e muajit janar 2023, sipas NOAA-s.

Anomaly values of average air temperatures for the European Continent for the 4 weeks of January 2023, according to NOAA.

Vendi ynë karakterizohet me anomali pozitive, të cilat veçanërisht në javë e tretë janë më të theksuara dhe shkojnë deri në +3°C deri +5°C në zonat të catuara.

Vlerat e temperaturave mesatare të ajrit dhe ndryshimet me vlerat e normës referuar periudhës 1961-1990 për një sërë vendmatjesh meteorologjike të Sistemit Kombëtar të Monitorimit Meteorologjik, janë të paraqitura në figurën Nr.10 tregojnë për një anomali prej +2.9°C në shkallë vendi.

Our country is characterized by positive anomalies, which especially in the third week are more pronounced and go up to +3°C to +5°C in certain areas.

The values of average air temperatures and the changes with the values of the norm referred to the period 1961-1990 for a series of meteorological stations of the National Meteorological Monitoring System, are shown in figure No.10, indicating an anomaly of +2.9°C on a national scale.



Figure Nr.10. - Vlerat e temperaturave mesatare të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të muajit Janar 2023 për Shqipërinë.
Values of mean air temperatures for some meteorological stations of January 2023 for Albania.

Ecuria ditore e temperaturave maksimale dhe minimale të ajrit për 12 vendmatje meteorologjike të përzgjedhura për disa zona e nënzona klimatike të vendit së bashku me ecurinë ditore të reshjeve janë paraqitur në grafikët e dhënë në figurën Nr.11.

Sa i takon temperaturave maksimale të ajrit në shkallë Europiane hartat e dhëna në figurën Nr.12 paraqesin situatën e këtij treguesi sipas 4 javëve.

Të dhënat e vlerave maksimale të temperaturave të ajrit, të cilat shënojnë vlera relativisht të larta gjatë këtij muaji ku vlen për tu theksuar java e dytë në pjesën veriore e Ultësirës Perëndimore në territorin e Shqipërisë që karakterizohet me vlerat mjaft të larta. Për territorin e Shqipërisë në lidhje me këtë tregues për një sërë vendmatjesh meteorologjike për muajin janar 2023 të dhënat paraqiten grafikisht në figurën Nr.13 ku evidentohet një anomali prej +3.6°C në shkallë vendi.

The daily progress of the maximum and minimum air temperatures for 12 meteorological stations selected for several climatic zones and sub-zones of the country together with the daily progress of precipitation are presented in the graphs given in Figure No.11.

As for maximum air temperatures on a European scale, the maps given in figure No.12 present the situation of this indicator according to 4 weeks.

The data of the maximum values of air temperatures, which mark relatively high values during this month, where it is worth noting the second week in the northern part of the Western Lowlands in the territory of Albania, which is characterized by very high values. For the country territory, related to this index for a series of meteorological stations for the month of January 2023, the data is presented graphically in figure No.13, where an anomaly of +3.6°C is evident on a national scale.

Figure Nr. 11/1÷11/12 - Temperaturat ditore për disa vendmatje meteorologjike për muajin janar 2023 në Shqipëri.
The daily temperatures for some meteorological stations for January 2023 in Albania.





Figura Nr.12. - Vlerat e temperaturave maksimale ekstreme të ajrit për kontinentin Europian për 4 javët e muajit Janar 2023, sipas NOAA-s.
Extreme maximal values of air temperatures for European Continent for the 4 weeks of January 2023, according to NOAA.



Figure Nr. 13. - Vlerat e temperaturave maksimale të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të muajit Janar 2023 për Shqipërinë.
Values of maximal air tempertaures for some meteorological stations of January month 2023 for Albania.

Ndërkohë vlerat maksimale absolute të temperaturave të ajrit për disa vendmatje meteorologjike janë paraqitur grafikisht në figurën Nr.14 për muajin janar 2023 për Shqipërinë.

Meanwhile, the absolute maximum values of air temperatures for some meteorological stations are presented graphically in Figure No.14 for the month of January 2023 for Albania.



Figure Nr.14 - Vlerat e temperaturave maksimale të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të muajit Janar 2023 për Shqipërinë.
Values of maximal air tempertaures for some meteorological stations of January 2023 for Albania.

Ashtu si vlerat e temperaturave maksimale të ajrit dhe ato minimale si në shkallë kontinentale dhe për vendin tonë paraqiten në terësi anomali pozitive. Në figurën në vijim Nr.15 paraqiten grafikisht të dhënat e temperaturave minimale për muajin janar për disa vendmatje meteorologjike të Shqipërisë. Si për temperaturat maksimale ashtu dhe ato minimale duhet theksuar se territori i vendit tonë përkundrejt situatës së këtyre treguesve në shkallë kontinentale ndodhet në periferinë e anomalive më të larta.

Like the values of the maximum air temperatures and the minimum ones, both on a continental scale and for our country, there are generally positive anomalies. In the following figure No. 15, the minimum temperature data for the month of January for several meteorological stations in Albania are presented graphically. Both for maximum and minimum temperatures, it should be noted that the territory of our country, compared to the situation of these indicators on a continental scale, is located in the periphery of the highest anomalies.



Figure Nr.15. - Vlerat e temperaturave minimale të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të muajit Janar 2023 për Shqipërinë.
Values of minimum air tempertaures for some meteorological stations of January month 2023 for Albania.



Figura Nr.16. - Vlerat e temperaturave minimale ekstreme të ajrit për kontinentin Europian për 4 javët e muajit Janar 2023, sipas NOAA-s.
Extreme minimal values of air temperatures for European Continent for the 4 weeks of January 2023, according to NOAA.

Në përfundim të kësaj analize për temperaturat e ajrit në vendin tonë në grafikun e dhëne në vijim në figurën Nr.17 paraqiten të dhënat e temperaturave minimale absolute të ajrit për muajin janar 2023 për disa vendmatje metorologjike.

At the end of this analysis of the air temperatures in our country, the following data graph in Figure No.17 shows the data of the absolute minimum air temperatures for the month of January 2023 for some meteorological stations.



Figure Nr.17 - Vlerat e temperaturave minimale ekstreme të ajrit për Shqipërinë për muajin Janar 2023.
Extreme minimal values of air temperatures for Albania for January 2023.

RESHJET ATMOSFERIKE

Reshjet atmosferike gjatë muajit janar 2023 kanë patur shpërndarje jo uniforme në shkallë kontinentale. Duke iu referuar figurës Nr.18 ku paraqiten reshjet dhe

ATMOSPHERIC PRECIPITTAION

Atmospheric precipitation during the month of January 2023 had uneven distri-bution on a continental scale. Referring to figure No.18 where rainfall and the



Figura Nr.18. - Reshjet për muajin Janar 2023 në kontinentin Europian dhe anomalitë kundrejt periudhës1981÷2010, sipas NOAA-s. / Rainfall for January 2023 at the European continent and their anomalies referring to the period 1981÷2010 according to NOAA.



Figura Nr.19. - Lartësia e reshjeve për disa vendmatje meteorologjike të muajit Janar 2023 për Shqipërinë. / The amount of precipitations for some meteorological stations of January month 2023 for Albania..

anomalitë përkatëse në shkallë Europiane, vërehet se në pjesën veriore të gadishullit Iberik, Britania perëndimore, Vendet e Ulta, territori i Ballkanit si dhe gadishulli i Apenineve me përjashtim të Siçilisë paraqiten me anomali pozitive të reshjeve.

Shqipëria preket nga këto anomali pozitive, të cilat duke iu referuar të dhënave nga Sistemi Kombëtar i Monitorimit Meteorologjik arrijnë në +41.1% kundrejt lartësisë mesatare të normës klimatike

correspo-nding nomalies are presented on a Euro-pean scale, it can be noted that in the northern part of the Iberian Peninsula, in western Britain, in the Netherlands, the territory of the Balkans, in the Apennine Peninsula with the exception of Sicily are positive rainfall anomalies.

Albania has been affected by these positive anomalies which, referring to the data from the National Meteorological Monitoring System, reach +41.1% compa-red to the mean height of the climatic norm

1961-1990 së reshjeve atmosferike, siç paraqiten grafikisht dhe në figurën Nr.19.

Në figurën Nr.20 paraqitet harta e shpërndarjes së reshjeve për territorin e Shqipërisë për muajin janar 2023. Zona e Alpeve Perëndimore dhe malësia jug-perëndimore janë zonat me lartësinë më të madhe reshjeve në gjithë territorin me më shumë se 300 mm, ndërsa pjesa juglindore ka më pak reshje në nivelin e 150 mm.

Në pjesën tjetër të territorit reshjet kanë patur mesatarisht një vlere prej 200 mm kryesisht në zonën qendrore me tendencë të theksuar rritje në pjesët malore.

Në figurën Nr.21 analizohet treguesi i numrit të ditëve me reshje nga ku për muajin janar 2023 kundrejt periudhës së normës klimatike 1961-1990 reshjet janë nën normë me -1.7 %. Si rrjedhojë vërehet intensitet i shtuar në raport të shpërndarjes kohore. Kjo situatë është e dukshme dhe në figurën Nr.21 ku numri i ditëve me reshje me intensitet mbi 20.0 mm është mbi 5 ditë sidomos në zonën fiziko-gjeografike të alpeve të Shqipërisë dhe në zonën Jug-Perëndimore.



Figure Nr.20. - Vlerat e reshjeve (në mm) për Shqipërinë për muajin Janar 2023.
The precipitation values (in mm) for Albania for the month of January 2023.

1961-1990 of atmospheric precipitation, as grafically are resented on the figure Nr.19.

Figure no. 20 shows the map of the distribution of rainfall for the territory of Albania during the month of January 2023. The area of the Western Alps and the southwestern highlands are the areas with the highest rainfall in the entire territory with more than 300.0 mm, while in the southeastern part there is less rainfall at the limit of 150.0 mm. In the rest of the territory, the rainfall continued to average 200.0 mm, mainly in the central area, with a pronounced tendency to increase in the mountainous parts.

Figure No.21 analyzes the indicator of the number of days with rain, where for the month of January 2023 compared to the climate norm period 1961-1990, the rainfall is below the norm by -1.7%. As a result, an increased intensity is observed in relation to the time distribution. This situation is also visible in figure No.21 where the number of days with rainfall with an intensity of over 20.0 mm is over 5 days, especially in the physical-geographic area of the Alps of Albania and in the area south-west.



Figura Nr.21. – Numri i ditëve me reshje për disa vendmatje meteorologjike të muajit Janar 2023 për Shqipërinë.
The rainy days for some meteorological stations of January month 2023 for Albania.



Figure Nr.22. - Vlerat e reshjeve (në mm) për Shqipërinë për datat 17, 18 dhe 19 Janar 2023
The precipitation values (in mm) for Albania for date 17,18 and 19 January 2023.

Ditët me më shumë reshje gjatë muajit janar 2023 ka qenë në intervalin kohor nga 17 deri në 19 janar të paraqitura në figurën Nr.22. Gjatë këtyre ditëve ka ushtruar ndikim fusha barike e presionit të ulët me qendër në veri të Adriatikut. Sistemi frontal, i cili ka kaluar gjatë këtyre ditëve ka sjellë reshje me intensitet 24 orësh mbi 50 mm në zonën e Nën-Shkodrës – Lezhë, siç tregohet dhe në figurën Nr.22.
Në figurën Nr.23paraqitet grafiku i reshjeve maksimale 24 orëshe e shoqëruar në figurën

The days with the most precipitation during the month of January 2023 was the time interval from January 17 to 19, presented in figure No.22. During these days, the baric field of low pressure, centered in the north of the Adriatic Sea, exerted its influence. The frontal system that has passed these days has brought rainfall with a 24-hour intensity of over 50 mm in the Nen-Shkodra Lezhe area as shown in figure No.22.
Figure No.23 shows the graph of maximum 24-hour rainfall accompanied in Figure

Nr.24 me hartën përkatëse ku zona veri-

No.24 with the corresponding map where



Figure Nr.23. – Reshjet maksimale 24 orëshe për disa vendmatje meteorologjike të muajit Janar 2023 për Shqipërinë.

The 24 hour maximal precipitation for some meteorological stations of January month 2023 for Albania.

përëndimore e Shqipërisë ka intesitetin më të lartë 24 orësh me mbi 80.0 mm reshje shiu.

Në vlerësimin e reshjeve atmosferike të vrojtuara për muajin janar 2023 një rëndësi të veçantë paraqet dhe treguesi i anomalive të tyre i shprehur në % kundrejt vlerave të normës. Në figurën në vijim Nr.xx paraqitet situata me vlerat e këtij treguesi në shkallë kontinentale ndërsa në mënyrë me të detajuar për vendin tonë këto anomali paraqiten në hartën e dhënë në figurën Nr.25.

Gjatë muajit janar 2023 u vrojtuan dhe reshje dëbore, të cilat kryesisht u vrojtuan në zonat malore në lartësi mbi 800 apo 1000 metër mbi nivelin e detit.



Figure Nr.24. – Lartësia maksimale 24 orëshe e reshjeve për muajin Janar 2023 për Shqipërinë.

The 24-hour maximal precipitation values of January month 2023 for

the northwest area of Albania has the highest 24-hour intensity with over 80.0 mm of rain.

In the assessment of the observed atmospheric precipitation for the month of January 2023, the indicator of their anomalies expressed in % compare to the norm values is of particular importance. The following figure No.xx shows the situation with the values of this indicator on a continental scale, while in more detail for our country, these anomalies are presented in the map given in figure No.25.

During the month of January 2023, snowfalls were also observed, which were mainly observed in mountainous areas at heights above 800 or 1000 meters above sea level.



Figure Nr.25 - Anomalitë e reshjeve për muajin Janar 2023 në kontinentin Europian (in %) sipas NOAA.

Precipitation anomalies for January 2023 on the European continent (në /in %) according to NOAA.

Figure Nr.26. – Anomalitë e reshjeve në % kundrejt vlerave të normës për muajin Janar 2023 për Shqipërinë.
The precipitations anomalies in % for January month 2023 compare to norm values for Albania.


Pamje nga kodrat e Shijakut në drejtimin veror. / View from Shijak hills on north direction. Photo: P.Zorba, 26.01.2023.

Figure Nr.27. – Situata e motit me datë 26 Janar 2023 për pjesën qendrore të Shqipërisë .
Weather situattion on date January 26, 2023 for central part of Albania.



Disa të dhëna për lartësinë e dëborës gjatë këtij muaji paraqiten në tabelën Nr.1 në vijim, ndërsa për ilustrim pamja në figurën Nr.27 tregon për mbulesën e deborës e kreshat e vargmaleve të Skënderbeut për zonën Krujë – Tiranë.
Në tërësinë e vlerësimit të reshjeve për muajin janar 2023 një informacion plotësues në shkallë kontinetale për dy peri

Some data on the height of the snow during this month are presented in the following table No.1, while for illustration the view in the picture No.27 shows the snow cover and the crests of the Skanderbeg mountain ranges for the area Krujë - Tirana.
In the entirety of the rainfall assessment for the month of January 2023, additional information on a continental scale for the

Table Nr.1 – Lartësitë e reshjeve të dëborës gjatë muajit janar 2023 në disa vendmatje meteorologjike për Shqipërinë.
Snow levels for some meteorological stations for Albania during the January 2023.

Nr.	Vendmatja meteorologjike Meteorological station	Bora / Snow (në/in cm)	No.	Vendmatja meteorologjike Meteorological station	Bora / Snow (në/in cm)
1	**Bilisht**	**18.5**	8	**Kalimash**	**12.0**
2	**Bishnicë**	**2.0**	9	**Narel**	**7.0**
3	**Dardhë**	**10.0**	10	**Petkaj**	**2.0**
4	**Dushar**	**10.0**	11	**Qarrishtë**	**5.0**
5	**Goricë Madhe**	**3.0**	12	**Rapsh**	**10.0**
6	**Grabovë**	**10.0**	13	**Rrëshen**	**31.0**
7	**Jaronisht**	**5.0**	14	**Topojan**	**3.0**

-udhat më të veçanta, ku dalin në pah reshjet e shumta të vrojtuara në vendin tonë.



Figure Nr.28

Parë në një këndvështrim kontinental në hartat e dhëna në vijim në figurat Nr.28 dhe Nr.29 paraqiten reshjet e periudhës 15-21 janar dhe ato të periudhës 21-27 janar 2023.

Mjaft qartë shihet se territori i vendit tonë si në pjesën veriore ashtu dhe atë jugore është karakterizuar në nivele mjaft të larta të reshjeve atmosferike përkundrejt gjithë hapësirës tjetër të kontinetit Europian.

for the two most special periods, where the huge amount of rainfall observed in our country stands out.

Seen from a continental perspective, the following maps in figures No.28 and No.29 show the rainfall for the period 15-21 January and those for the period 21-27 January 2023.

It is quite clear that the territory of our country, both in the northern and southern parts, is characterized by high levels of atmospheric precipitation compared to the rest of the European continent.



Figure Nr.29

